



## Epidemiologjia dhe strategjia e mjekimit të patologjive të gjendrës tiroide në qytetin e Vlorës

Msc. Lejdi Fetahu

Pedagoge në Departamentin e Farmacisë  
KOLEGJI UNIVERSITAR "REALD" VLORË  
[lejdifetahu@gmail.com](mailto:lejdifetahu@gmail.com)

### Abstract

Thyroid gland pathologies always have been for me an interesting topic for reasons because I have had relatives of my own, affected by these pathologies. Also, these pathologies are widespread across the globe. In this study I have treated the strategy of treatment in thyroid gland pathologies such as:

- hyperthyroidism
- hypothyroidism
- Hashimoto syndromes

This study was carried out by reviewing the patient records presented at the Polyclinic of the Vlorë City and the Vlorë's regional hospital in 2015, 2016, 2017. The data provided by the patient's files were classified according to:

- year
- diagnosis
- gender
- residence (town/village).

**Key words:** thyroid glands, hypothyroidism, hyperthyroidism, Hashimoto syndromes.

### Abstrakt

Patologjitë e gjendrës tiroide ekanë qenë për mua një temë gjithmonë interesante për arsye sepse kam patur të afërm të mite të prekur prej këtyre patologjive. Gjithashtu janë patologji mjaft të përhapura në mbare globin. Në këtë studim kam trajtuar strategjinë e mjekimit tek patologjitë e gjendrës tiroidesi:

- hipertiroidizmi
- hipotiroidizmi
- sindromi Hashimoto

Ky studim është kryer duke marr në shqyrtim kartelat e pacientëve të paraqitur në Poliklinikën e qytetit të Vlorës dhe në spitalin rajonal të Vlorës në vitet 2015, 2016, 2017. Të dhënat e siguruar nga kartelat u klasifikuan sipas:

- vitit
- diagnozës

- gjinisë
- vendbanimit (qytet/fshat).

**Fjalë kyçe:** gjëndratiroide, hipotiroidizëm, hipertiroidizëm, sindromi Hashimoto.

### Hyrje

Patologjitë e gjendrës së tiroides janë dy llojesh duke u ndarë në:


- hipotiroidizëm (sindromi Hashimoto më i shpeshti)
- hipertiroidizëm (sëmundja e Graves më i shpeshti)

Këto patologji karakterizohen nga çrregullime të prodhimit të hormone të tiroides, si:  $T_3$  dhe  $T_4$  të cilat janë mjaft të rëndësishme në mirëfunksionimin e organizmit duke luajtur rol në: rritje<sup>1</sup> dhe zhvillim të indeve dhe veçanërisht i rëndësishëm për zhvillimin dhe maturimin e sistemit muskullor, sistemit nervor dhe sistemit riprodhues.

Të dhënat e marra nga kartelat e pacientëve të diagnostikuar me këto patologji janë paraqitur më poshtë:

2015	Total	Femra	Meshkuj	Qytet	Fshat
Hipotiroidizmi	387	334	53	333	54
Hipertiroidizmi	107	87	20	91	16
Hashimoto	10	9	1	9	1

Tabela 1




<sup>1</sup> Shkoza, A. , Fiziologjia e njeriut, Botimi 2, Tiranë, Mars 2009, Ufo University Press, fq 370.



**Grafik 1**

2016	Total	Femra	Meshkuj	Qytet	Fshat
Hypotireoza	397	358	39	330	67
Hipertireoza	111	86	25	91	20
Hashimoto	9	8	1	9	0


**Tabela 2**



**Grafik 2**

2017	Total	Femra	Meshkuj	Qytet	Fshat
Hypotireoza	404	344	60	336	68
Hipertireoza	128	92	36	104	24
Hashimoto	14	14	-	13	1

**Tabela 3**



**Grafiku 3**

**Konkluzione:**

Duke parë të dhënat të cilat janë paraqitur nëpër tabela dhe grafikë dhe këto të dhëna janë ndarë sipas viteve, gjinisë, diagnozës dhe vendbanimit dalim në këto përfundime:

- Numri i pacientëve me hipotireozim ka ardhur duke u rritur dhe më të prekura janë femrat në krahasim me meshkujt:

Hipotireozim	Femra	Meshkuj
2015	85%	15%
2016	90%	10%

2017	85%	15%
------	-----	-----

**Tabela 4**

Shohim dhe që personat të cilët jetojnë në qytet janë më të prekura në krahasim me personat që jetojnë në fshat.

- Numri i pacientëve me hipertireozim ka ardhur duke u rritur dhe më të prekura janë femrat në krahasim me meshkujt.

Hipertireozim	Femra	Meshkuj
2015	81%	19%
2016	77%	23%
2017	72%	28%

**Tabela 5**

Duke u nisur nga vendbanimi personat të cilët janë më të prekura janë ata të cilët jetojnë në qytet.

- Personat me sindromin Hashimoto kanë ardhur duke u rritur dhe ata janë pacientë të cilët vjetojnë në qytet.

Hashimoto	Femra	Meshkuj
2015	90%	10%
2016	88%	12%
2017	100%	-

**Tabela 6**


Në kartela gjithashtu ishte shkruar dhe mjekimi i cili u është dhënë nga mjeku specialist endokrinolog:

- Në rastet me hipotireozim mjekimi që kanë marr ka qenë:
  - Levotiroksinë 50 mg + JodurKaliumi 200 µg
  - Levotiroksine 100 mg
- Në rastet me hipertireozim mjekimi që kanë marr ka qenë;
  - Propiltiouracil + Methimazol + metoprolol
- Në rastet me sindromin Hashimoto mjekimi ka qenë:
  - Selenium 100mg 1tab + Jodurkaliumi200µg + Levotiroksinë 50 mg (sipasnevojës)

**Gjendra tiroide, lokalizimi dhe struktura<sup>2</sup>**

Gjendra tiroide lokalizohet në pjesën e përparme të qafës, pak poshtë laringut. Gjendra tiroide është gjendra më e madhe endocrine e trupit. Në brendësi, gjendra tiroide përbëhet nga disa njësi strukturore që quhen folikuj. Muret e secilit folikul formohen nga qelija epitelialekubike ose te sheshta, që quhen qeliza folikulare. Këto qeliza prodhojnë glikoproteinën tiroglobulinë. Hormonet e tiroides formohen nga tiroglobulina e joduar.

<sup>2</sup> Shkoza, A. , Fiziologjia e njeriut, Botimi 2, Tiranë, Mars 2009, Ufo University Press, fq 370



**Figura 1: Gjëndra tiroide**

### Hormonet e tiroides<sup>3</sup>

Hormonet e tiroides që shpesh referohen si hormone kryesore metabolike të trupit, përfaqësohen nga dy hormone active të jodizuara, që janë **tiroksina (T<sub>4</sub>) dhe trijodtironina (T<sub>3</sub>)**. Hormoni kryesor që sekretohet prej folikujve të tiroides, është tiroksina. Kurse shumica e trijodtironinës formohet tek indet shenjë, si rezultat i shndërrimit të T<sub>4</sub> në T<sub>3</sub>. Hormonet e tiroides ndikojnë thuajse në çdo qelizë të trupit, por nuk ndikojnë në trurin e të rriturit, në shpretkë, në testikuj, në uterus dhe në vet gjëndrën tiroide. Hormonet e tiroides kanë rol kalorigjenik sepse stimulojnë enzimata që merren me oksidimin e glukozës dhe në këtë mënyrë rritet shpejtësia e metabolizmit bazal dhe prodhimin e nxehtësisë në trupin.

Rënia e nivelit të T<sub>4</sub>, stimulon çlirimin e hormonit stimulus të tiroides (TSH) dhe, rrjedhimisht, të vet tiroksinës. Rritja e nivelit të T<sub>4</sub> frenon me mekanizëm feedback aksinhipotalamo-hipofizar, duke ndërprerë kështu përkohësisht stimulimin për çlirimin e TSH-së. Situatat gjatë të cilave nevojat e trupit për energji rriten, si shtatëzania ose ekspozimi afat gjatë ndaj temperaturave të ulëta, stimulojnë hipotalamusin që të çlirojë hormonin çlirues të tirotropinës (TRH). TRH-ja, nga ana e saj, stimulon sekretimin e TSH-së e për rrjedhojë, edhe të T<sub>4</sub> e T<sub>3</sub>. Pas këtij stimulimi, gjëndra tiroide çliron sasi të bollshme hormone, duke rritur kështu metabolizmin dhe prodhimin e nxehtësisë. Faktorët që frenojnë sekretimin e TSH-së, janë: somatostatina, rritja e nivelit të glukokortikoideve dhe të hormoneve seksuale (estrogjen dhe progesteron) në gjak, si dhe përqëndrimi i lartë i jodureve në gjak.

Si<sup>4</sup> sekretimi i tepërt dhe imangët i hormoneve të tiroides, mund të shkaktojnë çrregullime të rënda metabolike. Hipotiroidizmi mund të jetë pasojë e ndonjë defekti të gjëndrës ose pasojë e çlirimit të papërshtatshëm të TSH-së a të TRH-së. Hipotiroidizmi gjithashtu mund të ndodhë edhe si rezultat i eliminimit kirurgjikal të tiroides ose i deficitit të jodit në dietë.

Tek të rriturit, sindroma e plotë e hipotiroidizmit quhet miksedemë (edemëmukoze). Simptomat e zakonshme


janë: ulja e shpejtësisë metabolike, ndjesia e të ftohtit, enjtja e syve dhe letargjia e dembelizmit mendor (por jo vonesa mendore). Kur miksedema ka si shkak mungesën e jodit, gjëndra tiroide zmadhohet. Kjo njihet si struma endemike. Në këtë rast, qelizat folikulare prodhojnë koloid, por nuk mund ta jodizojnë atë, pra nuk arrijnë të prodhojnë hormonin funksional. Në përpjekje për të stimuluar gjëndrën tiroide që të prodhojë hormone, hipofiza shton sekretimin e TSH-së, por rezultati është vetëm grumbullimi i një sasive më të madhe *koloidi të papërdorshëm*. Pa trajtim, vjen një çast që qelizat e gjëndrës tiroide "digjen" nga veprimtaria e tepruar dhe gjëndra atrofizohet. Në varësi të shkakut, miksedema mund të korrigjohet duke zëvendësuar jodin e munguar ose deficitin hormonal.

### Clinical features of hypothyroidism



**Figura 2: Shenjat e hipotiroidizmit**

Patologjia<sup>5</sup> më e zakonshme e hipertiroidizmit është **sëmundja Graves**. Serumi i këtyre pacienëve përmban antitropa jonormalë që imitojnë TSH-në dhe stimulojnë kështu çlirimin e vazhdueshëm të hormoneve të tiroides. Simptomat karakteristike janë: rritja e shpejtësisë metabolike, djerësitja e theksuar, rrahjet e shpejta dhe të çrregullta të zemrës, nervozizmi dhe rënia në peshë ndonjëse të sëmurët ushqehen normalisht.



**Figura 3: Simptomat e sëmundjes Graves**

### Sindromi Hashimoto<sup>6</sup>

E quajtur edhe sëmundja e Hashimotos, tiroiditi i

<sup>3</sup> Ibid

<sup>4</sup> Shkoza, A., Fiziologjia e njeriut, Botimi 2, Tiranë, Mars 2009, Ufo University Press, fq 371.

<sup>5</sup> Ibid

<sup>6</sup> <https://www.webmd.com/women/hashimotos-thyroiditis-symptoms-causes-treatments#1> marr më dt. 29.04.2018



Hashimotos është një sëmundje autoimune, një çrregullim në të cilin sistemi imunitar kthehet kundër indeve të trupit. Në njerëzit me Hashimoto-n, sistemi imunitar sulmon tiroidin. Kjo mund të çojë në hipotiroidizëm, një gjendje në të cilën tiroidi nuk prodhon mjaft hormone për nevojat e trupit.

Shkaku i saktë i Hashimotos nuk dihet, por shumë faktorë besohet të luajnë një rol. Ato përfshijnë:

**Gjenet.** Njerëzit që marrin Hashimoto shpesh kanë anëtarë të familjes që kanë sëmundje tiroide ose sëmundje të tjera autoimune. Kjo sugjeron një komponent gjenetik për sëmundjen.

**Hormonet.** Nga sindromi Hashimoto janë më të rrezikuara femrat sesa meshkujt, duke sugjeruar se hormonet seksuale mund të luajnë një rol. Për më tepër, disa gra kanë probleme me gjëndrën tiroide gjatë vitit të parë pas lindjes së një foshnjeje. Megjithatë problemet shëndetësore zakonisht largohen, në rreth 20% të këtyre grave sindromi Hashimoto u shfaqet përsëri më vonë.

**Jod i tepërt.** Hulumtimet sugjerojnë që medikamente të caktuara dhe shumë jod, një element gjurmë i rëndësishëm në organizëm për të prodhuar hormonet e tiroides, mund të shkaktojnë sëmundje të gjëndrës tiroide në personat e ndjeshëm ndaj jodit.

**Ekspozimi ndaj rrezatimit.** Raste të shumta të çrregullimeve të funksionit të gjëndrës tiroide janë raportuar tek njerëzit e ekspozuar ndaj rrezatimit, duke përfshirë bombardimet atomike në Japoni, aksidentin bërthamor të Çernobilit dhe trajtimin e rrezatimit për një formë të kancerit të gjakut të quajtur sëmundja Hodgkin.




Figura 4: Tiroidi Hashimoto

### Simptomat e tiroidit të Hashimotos

### Referencat

Shkoza, A. , Fiziologjia e njeriut, Botimi 2, Tiranë, Mars 2009, Ufo University Press,  
Koçi, R; Toska, F; Koroshi, A; Çaja, T,Sëmundjet e brendshmedhekujdiesiinfermieror, Tiranë , Janar 2007, MEDICOM A.P.T.C. SH.p.k.  
Boçari, G; Deda, L; Hoxha, A; Grabocka, E; Kakariqi,

Simptomat e sindromit Hashimoto mund të jenë të lehta në fillim ose të zgjasin vite për t'u zhvilluar. Shenja e parë e sëmundjes është shpesh një gjëndër tiroide e zgjeruar, e quajtur strumë. Struma mund të bëjë që pjesa e përparme e qafës të duket e fryrë. Një strumë e zmadhuar mund të bëjë gëlltitjen e vështirë. Simptoma të tjera të një hipotiroidizmi për shkak të Hashimotos mund të përfshijnë:

- shtim në peshë
- lodhje
- zbehje ose mpirje të fytyrës
- dhimbje të artikulacioneve dhe muskujve
- kapsllëk
- ndjesi të ftohti
- vështirësi në mbetjen shtatëzënë
- humbje e flokëve dhe flokët të brishtë
- çrregullim të ciklit menstrual
- depresion
- bradikardi

### Trajtime për tiroiditetin e Hashimotos

Nuk ka shërim për sindrimin Hashimoto, por zëvendësimi i hormoneve me medikamente mund të rregullojë nivelet e hormoneve dhe të rivendosë metabolizmin në normalitet.

Medikamentet që përdoren në sindromin Hashimoto janë në doza të ndryshme. Doza e saktë që përkrahur mjeku do të varet nga një numër faktorësh, duke përfshirë:

- moshën
- peshën
- stadi i hipotiroidizmit
- probleme të tjera shëndetësore
- medikamente të tjera që mund të ndërveprojnë me hormonet tiroide sintetike

Pasi të fillohet trajtimi me medikamente, mjeku do të rekomandojë një test laboratorik të quajtur test i hormonit stimulues të gjëndrës tiroide (TSH) për të monitoruar funksionin e tiroides dhe për të siguruar që është apo jo duke u marrë doza e duhur. Për shkak se hormonet tiroide veprojnë shumë ngadalë në trup, mund të duhen disa muaj që simptomat të zhduken dhe struma të zvogëlohet. Megjithatë, struma të mëdha dhe që nuk përmirësohen mund të çojnë në marrjen e vendimit për ndërhyrje kirurgjikale në gjëndrën tiroide.

Farmakologjia, Tiranë, 2010, Botimet Kumi

<https://www.webmd.com/women/hashimotos-thyroiditis-symptoms-causes-treatments#1>(marr më dt. 29.04.2018)